



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimet / Dorezuar Primiene/Prisatato Received/Delivered	05-05	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot br Prot Prot No	Shtesa e Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHCK	2612/2022		113	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.271/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi - Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.271/2021, të datës 22.03.2022, së ankuesit kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.05.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. **DETYROHET** Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të bëjë shqyrtimin e kërkesës së datës 07.09.2021 të parashtruar nga ankuesi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- II. **OBLIGOHET** Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën I të tij.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi më datë 22.03.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, kundër procesverbalit të datës 14.09.2021, të Komisionit për Grada dhe Disiplinë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 31.03.2022, ka bënë kërkesë për përgjigjen në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa më datë





06.04.2022, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka dërguar përgjigje në ankesë tek Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 22.03.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 1512/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 07.09.2021, Formulari për vlerësimin për nëpunësit e shënimit të jashtëm; Kërkesë e datës 02.07.2019; Vendimi i datës 06.09.20121; e- maili i datës 14.02.2022; e- maili i datës 17.03.2022; Vendimi i datës 30.12.2015, i Zëvendëskryeministrit të parë të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimi i datës 15.03.2022, i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD; Raporti i punës i datës 14.09.2021, i Komisionit për grada dhe disiplinë; Procesverbali i Komisionit për Grada dhe Disiplinë; Përgjigje në ankesë e datës 06.04.2022, me numër protokollit 1919/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1.4 të Ligjit 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar që ekziston baza ligjore për të vendosur, duke obliguar organin e punësimit, respektivisht Komisionin për Grada dhe Disiplinë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që ti ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme administrative në pajtim me kompetencat ligjore që ka, për të vendosur lidhur me shqyrtimin e kërkesës së datës 07.09.2021 të parashtruar nga ankuesi drejtuar Komisionit për Grada dhe Disipline pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kërkesë e cila ishte parashtruar pas njoftimit nga ana e Zyrës së Sekretarit të MPJD-së e datës 03.09.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisionin për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me parashtrimin e kërkesës së ankuesit të datës 07.09.2021 ka qenë i obliguar të veprojë në pajtim me nenin 131 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative” në pajtim me mandatin ligjor që ka duke iu referuar Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës nenin 30 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 ku përcaktohet se: “Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës ka për detyrë: 1.1. dhënien e gradave diplomatike dhe konsullore për nëpunësit e shërbimit të jashtëm në përputhje me këtë ligj dhe Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm” në mbështetje edhe të nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm ku përcaktohet se: “Gradimi në pozita më të larta dhe rritja në baza të meritave do të shqyrtohet nga Komisioni” ndërlidhur me nenin 12 paragrafit 2 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: “Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlefshmërinë e caktimit të gradave të anëtarëve që hyjnë në Shërbimin e Jashtëm dhe gradimin e zyrtarëve në kuadër të sistemit për vlerësimin e rezultatit të punës, ashtu siç përcaktohet me këtë rregullore”.*

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstatuar se pas pranimit të Vendimit të KPMSHCK-së, organi i punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës respektivisht Komisioni për Grada dhe Disiplinë, duhet të shqyrtojë kërkesën dhe të veprojë në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 Ligji nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, pasi që na bazë të procesverbalit të datës 02.12.2021 të Komisionit për Grada dhe Disiplinë të cilin ankuesi ka arritur ta ketë në posedim me datë 23.02.2022, të njëjtët nuk ka vendos sipas obligimeve





ligjore që kanë duke nxjerr akt administrativ përmes të cilit i pranohet apo i refuzohet kërkesë për avancim.

Andaj ndërlidhur me rastin në fjalë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi në rastin marrjes së vendimit nga Komisioni për Grada dhe Disiplinë është i pakënaqur me vendimin në fjalë, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi ka të drejtë t'i drejtohet me ankesë të re Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
Lënda me numër Anr.271/2022

**Rushit KAJTAZI**

*[Signature]*  
Procesmbajtës



**Eshref SHABANI**

*[Signature]*  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Komisionit për Grada dhe Disiplinë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së,